



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____prot.

Tiranë, më ___/___/2021

V E N D I M

Nr.179, datë 21/09/2021

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr.163, datë 13.09.2021, e z. Sh.H., ku pretendohet diskriminim për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Kavajë.

Në shqyrtimit fillestar të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi ka punuar zjarrëfikës pranë Sektorit të P.M.Z.SH., në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, pranë Bashkisë Kavajë, fillimisht përgjatë periudhës 2010-2014, e në vijim përgjatë periudhës kohore 07.12.2017 deri në datën 12.11.2020.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 436, datë 11.11.2020 “Për lirim nga detyra” të Shefit të Sektorit të M.Z.SH, ankuesi është liruar nga detyra, me motivacion “*për mosrespektim të orarit zyrtar dhe moszbatim të detyrave funksionale*”.

Ankuesi pretendon se diskriminohet për shkak të bindjes politike¹, nga ana e punëdhënësit.

Ankuesi sqaron se ka depozituar kërkesë padi me objekt – konstatimin e zgjidhjes së kontratës së punës mes paditësit dhe të paditurit, si të menjëherëshme dhe pa shkaqe të justifikuara etj. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, kundër Bashkisë Kavajë.

¹ Referuar kopjes së kartës së anëtarësisë së lëshuar në datën 14.05.2014, ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*bindjes politike*”, duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “*1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.*”

Mbështetur në aktet e e depozituara në cilësi prove dhe përkatësisht aktit “Kërkesë padi” të depozituar nga ankuesi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Komisioneri u vu në dijeni të faktit se, pretendimet për diskriminim për shkak të bindjeve politike, ankuesi i ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

Kjo reflektohet në kërkesë-padinë, datë 23.11.2020, paraqitur para gjykatës kompetente nga vetë subjekti ankues, në parashtrimet e tij. Kështu, në parashtrimet e kërkesë padisë, citohet, ndër të tjera: “*...Në vlerësimin tonë ligjor, zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga ana e të paditurit me*

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

paditësin Sh.H. është e pabazuar në prova dhe ligj, ndaj dhe e kundërshtojmë në rrugë ligjore duke kërkuar shpërblim dëmi. Në zgjidhjen e marrëdhënies së punës objektujmë se: Së pari, ajo është e pavlefshme, **pasi në vështrim të nenit 146/1/c të Kodit të Punës** është bërë pa shkaqe të arsyeshme. Kërkimi ynë në këtë rast bazohet edhe në këtë institut: Në zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme, neni 146 i Kodit të Punës, pika 1, gërma “c”, ku zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur...c) bëhet për motive të pandashme nga personaliteti i punëmarrësit (bindje politike), por që nuk ka lidhje legjitime me raportet e punës”.

Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se, në nenin 146, pika 1, gërma c), të Kodit të Punës parashikohet shprehimisht se:

“1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur:

.....

c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”

Dispozita e sipërcituar parashikon rastin, kur punëdhënësi është larguar nga puna, si pasojë e diskriminimit të ushtruar nga ana e punëdhënësit, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, që është ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Referuar përcaktimeve antidiskriminuese të kryera në Kodin e Punës, KMD sjell në vëmendje parashikimin e nenit 9 “Ndalimi i Diskriminimit”, të këtij Kodi, ku parashikohet shprehimisht:

“1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

.....

5. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:

.....
c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;”

Ndërkohë që në Kreun III, të LMD, parashikohet gjithashtu mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b) parashikon shprehimisht se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”*

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se çështja me objekt konstatim diskriminimi po shqyrtohet gjyqësisht, pasi referuar kërkesëpadisë së depozituar nga ankuesi rezulton se ai pretendon zgjidhje të kontratës së punës, pa shkaqe të arsyeshme, pasi diskriminohet nga punëdhënësi, për shkak të bindjes politike. Referuar informacionit të dhënë nga ankuesi, gjykata e rrethit gjyqësor Kavajë ka zhvilluar 2 seanca gjyqësore për shqyrtimin e objektit të kërkesëpadisë.

Komisioneri çmon se, në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte e rrethana janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor. Në këto kushte, konform nenit 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, së ndryshuar, prevalon shqyrtimi dhe vendimmarrja e këtij të fundit. Përsa më sipër, në kushtet kur kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, si dhe të nenit 33, pika 7/4 të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkaqet e pretenduara prej tij.

Bazuar në nenin 36, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, ku parashikohet shprehimisht se: *“3. Gjykata e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim. 4. Gjykata mund t'i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në

rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

Në nenin 33, pika 4, gërma b), të LMD, të ndryshuar parashikohet se:

“4. Ankesa nuk pranohet nëse:

.....

b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”

Për sa më sipër, KMD shprehet për mospranimin e ankesës mospranimin e ankesës nr.163, datë 13.09.2021, së z. Sh.H..

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Proçedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, (i ndryshuar), të ndryshuar, si dhe referuar neneve 12-13, nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 4, gërma b), 5, 7, 7/4 dhe 10, si dhe nenit 36 e vijues të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.163, datë 13.09.2021, së z. Sh.H., pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Punësim
Shkak – bindja politike
Lloji i vendimit - mospranim